

Syllabus i Lëndës: Gjuhë shqipe I

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit - Fillor
Titulli i lëndës:	Gjuhë shqipe I (Fonetikë)
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	E detyrueshme
Viti i studimeve:	I (i parë)
Numri i orëve në javë:	3 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc. dr. Muharrem Gashi
Detajet kontaktuese:	044 126 996 muharrem.gashi@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës	
	Përmes këtij kursi studentët do t'i zgjerojnë njohuritë e tyre paraprake përkitazi me: shqipen si gjuhë indoevropiane, prejardhjen e gjuhës shqipe, dokumentimin e saj, dialektet dhe rrugën e zhvillimit të saj. Ata do të njihen teorikisht dhe praktikisht edhe me elementet themelore të sistemit fonetiko-fonologjik dhe të normës gjuhësore: drejtshqiptimin, drejtshkrimin, dallimin e tingujve nga morfemat, klasifikimin e tingujve, nyjetimin e tyre; për prozodinë: rrokjen, theksin, intonacionin, dukuritë fonetike etj. Po ashtu do t'i thellojnë njohuritë e tyre edhe në fushën e leksikologjisë: sinonimet, antonimet; për ligjërimet - stilet dhe regjistrat e gjuhës etj.
Qëllimi i lëndës:	Lënda Fonetika e gjuhës shqipe ka për qëllim të ndihmojë studentët në nyjetimin e tingujve të gjuhës shqipe sipas kriterëve që përcakton fonetika standarde.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas kursit studentët do të jetë në gjendje: -të analizojnë problemet fonetike dhe fonologjike të shqipes; -të krahasojnë të folmet dhe strukturën dialektore të shqipes me atë standarde; -të vlerësojnë rëndësinë e përdorimit të shqipes dhe stilet e saj; të kuptojnë strukturën fonetike, dialektore dhe leksikore të shqipes me shkrim dhe me gojë; të zbatojnë njohuritë e fituara dhe t'i interpretojnë ato te nxënësit.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	#	#	#
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	#	#	#
Teste vlerësuese, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, gara, provim final)	1	4	4
Tjerër shëno:			
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Format e mësimdhënies dhe mësim nxënies: E kombinuar, varësisht nga lloji i ligjëratis: shpjegim, sqarim, ushtrime, analiza tekstore e ligjërimitore, diskutime debatuese, komentim, punë me grupe, çifte dhe individuale, demonstrim e interpretim, krahasim, shtruarje e shqyrtim idesh, ese krijuese, vetë krijim. Mjetet e konkretizimit/ TI; Tekstet, fletoret e punës, pjesëmarrje në programet elektronike shkollore.		
Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë dhe i dytë, seminari, paraqitja, projekti, provimi përfundimtar me shkrim dhe me gojë.		

Literatura	
Literatura bazë:	1. Anastas Dodi, <i>Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe</i> , Tiranë, 2004. 2. A. Hamiti <i>Fonetika dhe fonologjia gjuhës standarde shqipe</i> , Shkup, 2011, 3. Shkurtaj, Gjovalin (2010), <i>Gjuha e sotme shqipe</i> , Tiranë. 4. Jashari, Ali & Kryeziu, Bahtijar (2010), <i>Gjuhë amtare</i> (Njohuri për gjuhën fonetikë- morfologji-sintaksë) për studentët e Fakultetit të Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë. 5. Grup autorësh, <i>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</i> , Tiranë, 1976.
Literatura shtesë:	B. Beci, <i>Fonetika e gjuhës shqipe</i> , Tiranë, 2004. K. Topalli, <i>Theksi në gjuhën shqipe</i> , Tiranë, 1995 K. Topalli, <i>Sonantet e gjuhës shqipe</i> , Tiranë, 2001 K. Topalli, <i>Mbylltoret e gjuhës shqipe</i> , Tiranë, 2002 K. Topalli, <i>Fërkimoret dhe afrikatet e gjuhës shqipe</i> , Tiranë, 2003
Plani i detajuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	<i>Paraqitja e përmbajtjes së syllabusit. Krijimi i grupeve punuese. Zgjedhja e drejtuesve të grupeve. Gjuha dhe gjuhësia, koncepte e nocione. Gjuha dhe komunikimi</i>
Java e dytë:	<i>Historia, gjuha, populli, kombi, shteti. Shqipja gjuhë indoevropiane. Dialektet e gjuhës shqipe (1972)</i>
Java e tretë:	<i>Tingujt dhe aspektet e studimit të tyre. Aparati i të folurit. Klasifikimi i tingujve. Fonema dhe veçoritë e tingujve të të folurit.</i>
Java e katërt:	<i>Përshkrimi dhe klasifikimi nyjëtimor i zanoreve të shqipes. Diftongjet dhe togjet e zanoreve.</i>
Java e pestë:	<i>Përshkrimi dhe klasifikimi i bashkëtingëlloreve. Shkrimi i bashkëtingëlloreve(s, z dhe ç nistore).</i>
Java e gjashtë:	<i>Shkrimi i bashkëtingëlloreve(s, z dhe ç nistore).</i>
Java e shtatë:	<i>Testi i parë vlerësues me për qëndrim në shqipen standarde</i>
Java e tetë:	<i>Ndërrimet e fonemave në gjuhën shqipe (pozicionale dhe historike)</i>
Java e nëntë:	<i>Rrokja dhe ndarja e fjalëve në fund të rreshtit</i>
Java e dhjetë:	<i>Modifikimet e tingujve në rrjedhën e ligjërimit Proceset fonetike (shtesat, rëniet, përngjytja, buzorëzimi, qiellzorizimi, metateza, sinereza e diereza...).</i>
Java e njëmbëdhjetë:	<i>Theksi i fjalës në gjuhën shqipe.</i>

<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<i>Prozodia, intonacioni dhe struktura melodike e shqipes.</i>
<i>Java e trembëdhjetë</i>	<i>Fonostilistikë, lidhjet kuptimore të fjalëve në gjuhën shqipe: sinonimet, antonimet, homonimet; Frazheologjia e gjuhës shqipe.</i>
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	<i>Stilet funksionale në gjuhën shqipe: kuptimet për stilin; mjetet me vlerë stilistike dhe norma stilistike; veçoritë e stileve funksionale të gjuhës shqipe; Përsëritje njësisish të kaluara</i>
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	<i>Testi i dytë vlerësues</i>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Mirësjellja në pajtueshmëri me Statutin e UPZ-së.
 Pjesëmarrja në ligjërata dhe seminare është e detyrueshme, e cila vlerësohet me 10 pikë.
 Studentit i cili ka mbi 6 mungesa të paarsyeshme në ligjërata, nuk i jepet nënshkrimi për vijueshmëri si student i rregullt.
 Studenti nuk mund të hyjë në provim pa paraqitje të vlefshme.
 Ndalohet përdorimi i celularit në ligjërata, në seminare dhe në provime.
 Provimi është publik dhe mund të organizohet: me shkrim (përmes testit), ose me gojë, sipas Statutit të UPZ-së.
 Studenti kalon provimin me sukses me notat 6-10 (Statuti i UPZ-së).
 Studenti që zihet duke kopjuar nuk vlerësohet.